



Raport vjetor 2020

QENDRA RINORE ARDHMËRIA – KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2020

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2020

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmeria-Kline është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmeria-Kline gjatë vitit kalendarik 2020.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmeria-Kline të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. KURSET E PËRDITSHME

2. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

3. BASHKËPUNIMET & PARTNERITET

4. PROJEKTET

5. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. KURSET E PËRDITSHME:

1.1 KURS I GJUHËS ANGLEZE

Në mënyrë të rregullt ditore është organizuar kursi i gjuhës Angleze për të rinjë ne fillim te muajit Shkurt. Çdo ditë gjatë këtij muaji kanë përfituar nje grup i te rinjeve cilët edhe pse ishin shume entuziast per te mesuar dhe marrur njohuri te reja kursi eshte nderprere per arsye te Pandemis nga Corona Virus Covid19. Kursi eshte udhehequr nga vullnetari amerikan (Peace Corps-Bill Laurence). Ku gjithashtu eshte larguar apo evakuar nga qyteti jone me 13 Mars 2020 per arsye te sigurise shendetsore per nje kohe te pacaktuar.

2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

2.2 PROGRAMI FESTIV PËR FËMIJË ME RASTIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS.

Organizimi i një festë për të shënuar ditën e pavarësisë e organizuan të rinjtë në mënyrë që të aftësojm gjeneratat e reja për simbolet e shtetit të Kosovës dhe njëkohësisht për të festuar ditën e pavarësisë së bashku në Qender Rinore.

Punuar me 17 Shkurt 2019.



2.3 QENDRA RINORE ARDHMËRIA-KLINË ZBATOI PROJEKTIN "EDUKIM MJEDISOR"

Mbështetur nga Fondacioni i Gjelbërt i Ballkanit (BGF) dhe Instituti për Politikë Zhvillimore (INDEP), projekti është zhvilluar në qytetin Klinë. Ardhmeria, është duke zhvilluar fazen e dytë të projektit dhe ne kemi arritur të organizojmë punëtorë arsimorë në dy shkolla fillore dhe një grup i rregullt i zhvilluar në qendrën e të rinjve, në pjesën e dytë të projektit kemi hartuar iniciativë për të promovuar diversitetin kulturor dhe fushata ndërgjegjësuese për mjedisin, aktivitetet e zbatuara prej 5 janar-5 Prill '19 do të përshkruhen më poshtë:

❖ WORKSHOPI I RREGULLT EDUKATIV

Grupi i rregullt u formua nga thirrja e hapur që ne bëmë në fillim të projektit, idea për të pasur një grup të rregullt të fëmijëve që ata mund të takohen çdo javë në qendrën e të rinjve. Grupi i 29 fëmijëve të moshës 12-13 vjeç takohen çdo javë dhe marrin pjesë në punëtorinë arsimore, këto punëtori drejtohen nga të njëjtët trainerë dhe vullnetarë me qëllim të mbështetjes dhe edukimit të fëmijëve se si të përdorin kreativitetin dhe riciklojnë artikuajt që përdorim në shtëpi apo shkollë.

❖ PROMOVIMI I DIVERSITETIT KULTUROR

2.4 PASTRIMI I PARKUT AFËR LUMIT KLINA DHE SHESHI NUE PËRLLESHI.

Iniciativa për pastrimin e parkut afër lumit Klina dhe Sheshi Nue Perlleshi, është realizuar në bashkëpunim me dy shkolla fillore: Sh.F. Ismet Raci dhe Sh.F. Motrat Qiriaz. Në këtë aktivitet morën pjesë 45 nxënës të shoqëruar nga mësuesit e tyre dhe ekipi punues i Qendrës Rinore. Iniciativa e pastrimit është realizuar me qëllim të edukimit dhe ndërgjegjësimit të të rinjve dhe qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë këtij aktiviteti, gatishmëria dhe përkushtimi i nxënësve dhe mësuesve ishte jashtëzakonisht i lartë, duke shprehur dëshirën dhe interesin për aktivitetet në natyrë dhe mbrojtjen e mjedisit. Për të zbatuar këtë iniciativë kemi bashkëpunuar me: Drejtorinë e Arsimit në komunën Klinë, Mësuesit e edukimit qytetar, Zyrtarin e Mjedisit nga autoritetet lokale dhe kompaninë "Ambienti" për mbledhjen e qeseve të mbeturinave në park.



2.5 VIZITË NË BURIMIN NATYRORË TË UJIT-PUSI I JARINES NË KLINË.

Vizita në burimin natyror të quajtur Pusi Jarines i cili është realizuar në bashkëpunim me dy shkolla fillore: Sh.m.u. Ismet Raci dhe Sh m.u Motrat Qiriaz. Vizita është bërë me 41 nxënës të shoqëruar nga mësuesit dhe ekipi punues i Qendrës Rinore. Iniciativa për të vizituar Pusi i Jarines kishte për qëllim promovimin e burimit natyror të Klinës dhe është bërë për herë të parë një vizitë e tillë, ku fëmijët mësuuan vendin ku ndodhet dhe historinë e Pusit të Jarines.



Zhvilluar me 21 mars 2019.

2.6 VIZITË NË UJËVARAT E MIRUSHËS.

Në kuadër të këtij projekti kemi bërë një vizitë në Ujëvarat e Mirushës, në këtë aktivitet morën pjesë 44 nxënës të shoqëruar nga dy mësues dhe 11 vullnetarë nga Qendra Rinore. Iniciativa për të vizituar Ujëvarat e Mirushës është implementuar me qëllim që të rinjtë nga shkollat e

Klinës të vizitojnë bukuritë natyrore lokale me qëllim të rritjes së aktivizimit të të rinjve dhe përfshirjes së tyre në mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë këtij aktiviteti, vullnetarët zhvilluan lojëra për fëmijë në natyrë dhe të gjithë u argëtuan në një mjedis të bukur natyror siç është Ujëvara Mirushës, dëshira dhe angazhimi i nxënsëve dhe mësuesve ishte shumë i lartë, duke shprehur dëshirën dhe interesin e aktiviteteve në natyrë dhe mbrojtjen mjedisore.

Zhvilluar me 23 Mars 2019 .



❖ **FUSHATA E NDËRGJEGJËSIMIT MJEDISOR**

1. **Broshura** - dy ditë vullnetarët kanë shpërndarë broshura vetëdijësuese në qytetin e Klinës me qëllim të krijimit të vetëdijes për mbrojtjen e mjedisit; përmbajtja e broshurës përmbante këshilla këshilluese dhe ndërgjegjësim për mbrojtjen e mjedisit.

Zhvilluar me 25 Mars 2019



2. **Video sociale mediatike** - gjatë gjithë projektit kemi bërë foto dhe incizim kështu që në fund të projektit është përgatitur një video dixhitale me qëllim të promovimit të projektit tonë dhe gjithashtu për ta bërë atë të dukshëm për publikun dhe shtrirjen e ndikimit më të madh dhe në të njëjtën kohë për të promovuar biodiversitetin natyror të Klinës. <https://www.facebook.com/QRAKline/videos/633085603830417/>

2.7 WORKSHOP ARGETUES PËR FËMIJË

Pasi që në Kosovë praktikohet pushimi pranveror fëmijët prap se prap vin në qender rinore për të marrur pjesë në aktivitete dhe për tu argëtuar. Vullnetaret organizuan lojëra për fëmijë dhe punuan gjëra kreative.

Zhvilluar me 4 Prill 2019.



2.8 WORKSHOP EDUKATIV

Grupi i fëmijëve i shoqëruar me stafin dhe 3 vullnetare zhvilluan një aktivitet në natyrë dhe punuan byzylykë kreative me lule. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte që fëmijët të krijojnë diçka nga natyra dhe të vizitojnë pas një muaji parkun të cilin kishin pastruar, të shohin si duket tanimë parku afër Lumit Klina.

Gjithashtu përpos natyrës së bukur të pranverës u vërejtën edhe shishet e plastsikës të hedhura në lumin Klina.



Zhvilluar me 15 Prill 2019

2.9 PROMOVIMI I PUNËS VULLNETARE Kohe pas kohe ekipi qendres ftohet nga Radio lokale në mënyrë që të njoftojmë qytetarët për aktivitetet të cilat zhvillohen në qendër rinore. Tema e programit të mëngjesit ishte promovimi i punës vullnetare dhe aktivizimi i rinisë. Gjithashtu egziston edhe grupi rinor dhe ky grup është antarë i rrjetit ndërkombëtar "People to people International" që kanë për mision punën vullnetare në komunitet. Për të biseduar rreth iniciativave rinore në Radio Alba ishin antarët e grupit rinorë, Klina youth chapter" Elineta Culaj dhe Laureta Duhanaj.



Zhvilluar me 18 prill 2019

2.10 GLOBAL YOUTH SERVICE DAY

Me moton: „Ejani të bëjmë ndryshimin në gjërat që shihen, grupi rinor "Klina Youth Chapter" i cili vepron në kuadër të Qendrës rinore Ardhmeria zhvilloi një aktivitet dedikuar tokës dhe mirëmbajtjes së mjedisit në Klinë.

Këtë vit grupi rinor



zhvilloi një iniciativë për ngjyrosjen e ulsëve të parkut afër lumit Klina. Në realizimin e kësaj iniciative moren pjesë 49 të rinjë nxënës të shkollave të Klinës, Ojq KOHA, KVRL Klina, ku së bashku jemi kujdesur për mirëmbajtjen e pronave publike sepse ky është vendi jonë dhe ne si qytetar duhet të përkushtohemi personalisht që ta mirëmbajmë. Me përkushtim dhe vullnet të madh të rinjtë së bashku me përkrahësit dhe organizatorët punuan gjatë tërë ditës duke pastruar dhe ngjyrosur 50 ulsë që gjenden në parkun afër lumit Klina. Ky aktivitet është mbështetur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike me (dorëza, ngjyra dhe hamburgera) dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport të komunës Klinës.

2.11 FUSHATË LOBUJSE

9 Maj, Dita e Evropës, viti 2019 dhe rinia kosovare ende e izoluar dhe të pa intergruar në Evropë. Fushata lobuese “Alloë us to move outside the cage”, është përgaditur nga vullnetarët e [Qendres Rinore Ardhmëria Klinë](https://www.ardhmeria.com) me qëllim që të parashtrijnë kërkesat e të rinjve ndaj Evropës dhe llobojnë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Të rinjtë kanë marshuar në qytetin e Klinës si dhe kanë përgaditur një fushatë lobuese e cila është publikuar në rrjetet sociale. <https://youtu.be/iy0-7WjG55A>.

Zhvilluar me
09 Maj 2019



2.12 **WORKSHOP** **RECIKLUES**

Kohe pas kohe janë organizuar ëorkshonet recikluese për fëmijë në menyrë që të edukojm fëmijët për riciklim. Fëmijët punuan një pemë prej letre me ngjyra të ndryshme, secili fëmijë me kreativitetin e tij është munduar që pemën ta punojë që i pelqen. Fëmijët u shprehën shumë të kënaqur me punën dhe kreativitetin.

Zvilluar me 20 maj 2019



2.13 DITA BOTËRORE KUNDER DUHANIT

Në ditën botërore kunder duhanit kemi organizuar një Workshop për të rinjë, kemi pasur për qëllim senzibilizmin dhe edukimin e të rinjve për pasojat e duhanit dhe substancave narkotike. Workshopi është udhëhequr nga tri vullnetaret: Albisona Gashi, Agnesa Berisha dhe Rinesa Gashi.

Zhvilluar me 31 Maj 2019.



2.14 QËRSHORI 2019

Festa 1 Qershorit në Klinë është organizuar nga vullnetaret e organizatës dhe grupit rinor “Klina youth Chapter”. Vullnetaret së bashku me fëmijë kanë marshuar në qytet si dhe kanë zhvilluar lojra për fëmijë tek parku afër Lumit Klina. Në këtë aktivitet moren pjesë rreth 100 fëmijë ku gjatë tërë ditës vullnetaret kanë qenë të gatshëm dhe të përgaditur për të zhvilluar lojra edukuese dhe rekreative për fëmijë.



2.15 WORKSHOP

Me 10 Qershor si çdo të hënë, fëmijët moren pjesë në aktivitetin kreativ dhe punuan me letër të ngjyrave të ndryshme. Workshopi është realizuar me udhëheqjen e tri vullnetareve lokale.

EDUKUES-RICIKLUES





2.16 PROGRAMI VEROR 2019

Programi veror është zhvilluar nga 8-19 Korriku dhe ka zgjatur dy javë me aktivitete për fëmijë. Programi ka pasur për qëllim zhvillimin e të rinjve për të udhëhequr dhe zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet e të rinjve për të punuar me fëmijë.

Programi është zhvilluar çdo ditë dhe në secilin ditë kanë qenë të angazhuar shumë vullnetar për të realizuar aktivitetet me fëmijë. Aktivitetet kanë filluar më lojra dhe aktivitete edukuese për moshën 6-10 vjeq. Gjithashtu në kuader të programit janë zhvilluar Animacione, workshope me temën për tu ushqyer shëndetshëm dhe për mirëbajtjen e higjenes personale.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve është përdorur metoda edukimit jo-formal dhe puna ekipore kreative për të edukuar fëmijët si dhe të njëjten kohë të zhvillojnë lojra dhe të arctohen njëkohësisht.

Në ditën e fundit është bërë përmbyllja e programit veror dhe vullnetaret kanë zhvilluar aktivitete të karakterit arctues dhe lojra si: Pantomima, Karaoke dhe vallëzim. Gjithashtu në këtë ditë fëmijët kanë zbuluar shokun e tyre sekret që gjatë tërë programit secili fëmi ka pasur një shokë sekret që ka dhënë dhurata, komplimente si dhe denime dhe me një koktej të organizuar nga vullnetaret. Gjithashtu fëmijët kanë zbuluar shokun sekret në ditën e fundit duke i mbyllur sytë dhe duke u munduar ta gjejnë se kush janë. Të gjithë fëmijët janë ndarë të kënaqur gjatë këtyre 2 javëve dhe shpresojmë që të vazhdojmë të zhvillojmë aktivitete të tilla.





2.17 Në programin e mëngjesit "Nise Ditën Mbarë" në Radio Alba.

Mysafir në studio ishte ekipi i qendres dhe dy vullnetare, qëllimi i këtij programi ishte që të prezantohet projekti "Take care of the Enviroment If you want to live Healthier" dhe përvoja e pjesëmarrjeve reja në konferencën ndërkombëtare PTPI në Varna të Bullgaris.



të

Zhvilluar me 12 Shtator 2019.

PROMOVIMI I PROJEKTIT "TAKE CARE OF THE ENVIROMENT IF YOU WANT TO LIVE HEALTHIER".

2.18 TRAJNIM PËR TË RINJË.

Projekti "Take care of the ENVIROMENT if you want to live HEALTHIER" i përkrahur nga #UNDPKosovo ka për qëllim t'u sigurojë të rinjve mjete përkatëse trajnimi, të ofrojnë aftësi të reja për avokim dhe lobim mbi të drejtat për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe më të pastër në Klinë, në menyrë që të inkurajojë të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimin për ndotjen e ajrit për komunitetin Klinës. Në kuader të projektit kemi zhvilluar trajnimin 3 ditor që moren pjesë 20 të rinjtë të qytetit dhe fshatrave të Klinës.



2.19 SHËNIMI I 20 VJETORI TË THEMELIT TË QENDRES RINORE “ARDHMËRIA-KLINË”

20 vjet punë, përkushtim, vullnetarizëm mbi të gjitha nostalgji... 1 Tetori i vitit 1999 shënon ditën e themelimit të qendrës. Në sallën ku çdo javë inskenohen aktivitetet, këtë të martë është rrëfyer një histori e vërtetë. Salla e qendrës rinore është shndërruar në hapësirë nga ku përmes muzikës e fjalëve, kokteit dhe një video përmbledhëse. Qendra Rinore „Ardhmëria” ka festuar ditëlindjen e 20-të. Të ftuar të shumtë, vullnetar dhe themelues gjithsecili në mënyrën e vete rrëfyer si kjo qendër është themeluar me çfarë sfida është përballuar, si ja kemi arritë dhe mbi të gjitha folën për kujtimet e panumërta që i dhanë jetë kësaj qendre që 20 vite, gjithë duke qenë përlusht falenderues ndaj gjithë atyre që financuan Qendrën dhe projektet e saj si dhe gjithsecilit që sado pak ka kontribuar që kjo Qendër Rinore të ketë vazhdimësi.



Bashkthemelues, vullnetar dhe kontribues të Qendrës Rinore për zemërsisht iu faleminderit...

[https://www.youtube.com/Watch?v=mVN-](https://www.youtube.com/Watch?v=mVN-yL4MZLo&feature=share&fbclid=IwAR1BKw9mbcFt948nLByNW0II8jQyZtyFZUIAS_1SAJNEHDL2ZpwBOCF4fOo)

[yL4MZLo&feature=share&fbclid=IwAR1BKw9mbcFt948nLByNW0II8jQyZtyFZUIAS_1SAJNEHDL2ZpwBOCF4fOo](https://www.youtube.com/Watch?v=mVN-yL4MZLo&feature=share&fbclid=IwAR1BKw9mbcFt948nLByNW0II8jQyZtyFZUIAS_1SAJNEHDL2ZpwBOCF4fOo)

2.20 LIGJERATA NË SH.M.U. “TRE DËSHMORËT”.

– Jashanic u mbajtë ligjerata me temën „E drejta për të jetuar në një ambient të shëndetshëm” në kuadër të projektit me po të njëjtin emër i financuar nga [UNDP Kosovo](#) dhe implementuar nga [Qendra Rinore Ardhmëria Klinë](#)

Gjithsej nga kjo ligjeratë përfituan 23 nxënës të klasës së IX të cilët morën njohuri rreth (Të drejtës si të jetojmë në një ambient të shëndetshëm, si të avokojmë dhe llojmë, dhe çka është ndotja dhe llojet e ndotjes, pasojat nga ndotja, dhe mbrojtjen e ambientit) dhe në fund nxënësit dolën me 2 prioritete gjegjësisht I vunë në pah problemet me të cilat ata ballafaqohen si fshat dhe si shkollë më së shumti dhe u munduan të gjenim zgjidhje brenda mundësive për secilin nga ato prioritete.

Zhvilluar me 08.10.2019



2.21 LIGJERATA NË SH.M.U. “ISA BOLETINI”

– Drenoc u mbajtë ligjerata me temën „E drejta për të jetuar në një ambient të shëndetshëm” në kuadër të projektit me po të njëjtin emër i financuar nga [UNDP Kosovo](#) dhe implementuar

nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë. Gjithsej nga kjo ligjeratë përfituan 24 Nxënës të klasëve të VIII-IX të cilët morën njohuri rreth të drejtës si të jetojm në një ambient të shëndetshëm, si të avokojm dhe llojm, dhe qka është ndotja dhe llojet e ndotjes, pasojat nga ndotja, dhe mbrojtjen e ambientit, në fund nxënësit dolën me 3 prioritete gjegjësisht i vunë në pah problemet me të cilat ata ballafaqohen si fshat / lagje dhe si shkollë më së shumti u munduan të gjenim zgjidhje brenda mundësive për secilin nga ato prioritete.

Zhvilluar me 10.10.2019 në Drenoc, Klinë.



2.22 LIGJERATA PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Pasi që trajneret nga organizata [#BalkanGreenFoundation](#) ishin duke zhvilluar ligjerata për mbrojtjen e mjedisit në rajonin Pejë, në Klinë organizuam një grup të rinjve të cilët përfituan nga kjo ligjeratë.



2.23 LIGJERATA NË SH.M.U. "MOTRAT QIRIAZI"

– Klinë u mbajtë ligjerata me temën „E drejta për të jetuar në një ambient të shëndetshëm “ në kuadër të projektit me po të njëjtin emër i financuar nga [#UNDP](#) dhe implementuar nga Qendra Rinore „ Ardhmëria - Klinë. Gjithsej nga kjo ligjeratë përfituan 24 Nxënës të klasëve të VIII-IX të cilët morën njohuri rreth(të drejtës si të jetojm në një ambient të shëndetshëm, si të avokojm dhe llojm, dhe qka është ndotja dhe llojet e ndotjes, pasojat nga ndotja, dhe mbrojtjen e amientit) , nxënësit dolën me 3 prioritete gjegjësisht i vunë në pah problemet me të cilat ata ballafaqohen si qytet dhe si shkollë më së shumti, çfarë pasojash kanë nga ato probleme me ambientin si do të avokonin dhe lobonin për problemin e tyre si dhe u munduan të gjenim zgjidhje brenda mundësive për secilin nga ato prioritete.



2.24 LIGJERATA NË SH.M.U. “ISMET RACI”– Klinë u mbajtë ligjerata me temën „ E drejta për të jetuar në një ambient të shëndetshëm “ në kuadër të projektit me po të njejtin emër i financuar nga #UNDP dhe implementuar nga Qendra Rinore „ Ardhmëria ‘’- Klinë. Gjithsej nga kjo ligjeratë përfituan 20 Nxënës të klasëve të VIII- IX të cilët morën njohuri rreth(të drejtës si të jetojm në një ambient të shëndetshëm, si të avokojm dhe lobojm, dhe qka është ndotja dhe llojet e ndotjes, pasojat nga ndotja, dhe mbrojtjen e amientit) dhe në fund nxënësit dolën me 3 prioritete gjegjësisht i vunë në pah problemet me të cilat ata ballafaqohen si qytet dhe si shkollë më së shumti, çfarë pasojash kanë nga ato probleme me ambientin si do te avokonin

dhe lobonin per problemin tyre si dhe munduan gjenim zgjidhje brenda



e u të

mundësive për secilin nga ato prioritete.

2.25 HALLOWEEN N’KLINË

Ngjarja kulturore Halloween n’Klinë është organizuar nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë dhe grupi rinor Klina youth Chapter, kemi realizuar aktivitete kulturore dhe edukative me rastin e festës së Halloëeenit, ku i kemi shfaqur prej orës 16:00 deri 18:30 në qender të qytetit të Klinës. Falenderim i madh I’u takon 35 antarëve të Qendres Rinore Ardhmëria ku kanë punuar me shumë përkushtim për të realizuar një event aq madheshtor në komunën e Klinës. Këtë vit moren pjesë një numër shumë i madh i fëmijëve të cilët shumica e tyre ishin të shoqëruar nga prinderit e tyre, fëmijët paten mundësi të vizatojn fytyrat dhe të marrin pjesë në 8 lojëra me shpërblime që gjithsejtë këtë vit janë shpërndarë 1400 shpërblime.

Organizimi jonë pati ndikim në socializimin e qytetarëve të qytetit dhe arzetimin e fëmijëve. Festa Halloween u përmbyll më një vallëzim për fëmijë dhe të rinjë nga vullnetaret e Qendres Rinore Ardhmëria-Klinë.

Zhvilluar me 31 Tetor 2019.





2.26 PËRZGJEDHJA E KRYESISË SË GRUPIT RINOR “KLINA YOUTH CHAPTER”

Mbrenda qendres rinore ekziston edhe grupi i të rinjve që cdo vit bëjnë regjistrimin e antarëve të rinjë dhe njëkohësisht edhe zhvillojnë takimin vjetor dhe përzgjedhjen e kryesisë së grupit, Kryetarin, zv.Kryetarin, Sekretarin dhe Arkatarin. Grupi rinor është grup aktiv, jo-formal i cili është antarë i PTPI'së ndërkombëtare.



2.27 TRYEZË E RRUMBULLAKËT

Organizim i një Tryezë të rrumbullakët për avokim në lidhje me sfidat rinore në nivelin komunal. Tryeza është organizuar nga Qendra rinore e Lipjanit, në bashkëpunim me qendren rinore dhe moren pjesë përfaqësuesit Komunal dhe të rinjtë e organizates Ardhmëria.

Zhvilluar më 20 Nëntor 2019, në Klinë



2.28 FUSHATË LOBUESE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE.

Fushata është organizuar në formë digjitale dhe në bashkëpunim me shumë të rinjë dhe mesues. Të rinjtë dhe fëmijet llobojnë për të drejtat e tyre në ditën e konventës së 20 Nëntorit. Fushatën mund të shihni në linkun: <https://www.youtube.com/Watch?v=t6R6WP-5t-8&fbclid=IWAR2atLA6vi6qufpZgqMqUX6S5rObIlitYjhgWscUlguzODEiZhzHB1XtAK8>

Publikur më 20 Nëntor 2019.

2.29 VIZITË KULTURORE

Në Mozaikun e Dresnikut, fshat i cili është një prej lokaliteteve arkeologjike me të rendësishme në Kosovë dhe Ujëvarat e Mirushës. Në këtë vizitë kulturore kanë marrur pjesë të rinjë dhe zyrtar nga komuna e Pejës, Gjakovës dhe Klinës. Vizita është organizuar nga [DKRS-Klinë](#) dhe monitoruar nga [OSCE Mission in Kosovo](#).

Vizita e realizuar me 22 Nëntor

2019.



2.30

DEKORIM I QENDRES

Përgaditjet e zbukurimeve për Krishtlindje dhe vitin e ri

2 Dhjetor 2019.



2.31 AKTIVITETET HUMANITARE

Bizneset Private: Dy grupe të të vullnetareve kanë vizitur bizneset e qytetit të Klinës në mënyrë që të mbledhim fonde për bamirësi, dhe mund të shprehemi se më shumë përkrahje kemi pasur nga bizneset e vogëla sesa nga ato biznese të mëdha.

Punimi i kartolinave: Vullnetaret punuan kartolinat e festave të fundvitit të cilat janë shitur në qendër të qytetit me qëllim për të ngritur fondin për familjet në nevojë.

Shitja e embëlsirave: Të rinjtë organizuan që secili prej tyre të gatujnë embëlsira dhe torte në shtëpi dhe ato të sjellin në grup që së bashku dy ditë të ftoftë dimri të shesin në qytet.

Nata e filmit: Në qendër janë organizuar 3 netë për shfaqje të filmit, në pjesën e paradites janë shfaqur 3 filma për fëmijë ndërsa në mbrëmje tri netë janë shfaqur Filma për të Rinjë Nga të gjitha aktivitetet vullnetaret kanë mbledhur 501.96 euro dhe me këtë shumë janë blerë ushqimet dhe pakot për familjet e varfëra të komunës së Klinës.



2.32 PAKETIMI DHE PËRGADITJA E NDIHMAVE

Paketimi i gjërave ushqimore dhe i veshmbathjeve është bërë nga antarët e qendres rinore "Ardhmëria" gjithashtu shumë veshmbathje dhe miell janë sjell nga grupi i tifozëve "HITHAT".



2.33 SHPËRNDARJE E NDIHMAVE

Shpërndarja e ushqimit dhe veshmbathjeve për familjet në nevojë, është bërë nga antarët e qendres [Qendra Rinore Ardhmëria Klinë](#) dhe grupi i tifozëve HITHAT, për familjet në nevojë, shumë të rinjë u angazhuan dhe punuan me perkushtim të madh. Rinia e Klinës u treguan solidar në ditën botërore të solidaritetit dhe gjithësej ndihmuan 18 familje në Komunën e Klinës.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport z. [Skender Merturi](#), ka qenë i gatshëm për të dhënë kontributin e tij në organizimin e shpërndarjes.

Realizuar me 20 Dhjetor

2019.



2.34 CHRISTMAS PARTY/ FESTË PËRMBYLLESE E VITIT

Qendra Rinore "Ardhmëria-Klinë", po përfundon një vit me shumë aktivitete të cilat i festuam me një party me muzik, karaoke dhe aheng ku morën pjesë shumë vullnetarë të cilët në fund u çertifikuam për punën vullnetare gjatë vitit 2019.

Ju urojmë të gjithëve Krishtilindjen dhe Vitin e Ri 2020!

23 Dhjetor 2019



3. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

3.1 PEOPLE TO PEOPLE INTERNATIONAL EUROPE NË KLINË pas promovimit të aktiviteteve rinore në Klinë dhe në bazë të aktivizimit të vullnetareve lokal, rrjeti ndërkombëtar PTPI vendosi që ta na vizitoj dhe të organizojm së bashku një trajnim 1 ditor për grupin e vullnetarëve për të ngritur kapacitet rinore në organizim të punës ekipe. Ekipi PTPI për herë të parë vizitoi qendren rinore dhe vullnetaret tonë dhe u mahniten nga motivimi dhe energjia e punës vullnetare në Klinë. Vullnetaret paten mundësi që të marrin informata rreth grupeve rinore të botës si dhe mundësitë për përfitimin e bursave nga PTPI. Njëkohësisht PTPI organizon konference botërore në Shtator 2019 në Bullgari dhe përzgjidhen dy vullnetare për të marrur pjesë dhe për të prezantuar qendren rinore Ardhmëria-Klinë në këtë konferencë madheshtore.

-Liderja e Grupit Rinor Elienta Culaj dhe antarja Beatrisa Culaj kane marrur pjesë në Konferencen botërore të People to People international ne Bullgari si dhe kanë prezantuar punën e Grupit rinor dhe aktivitetet e Qendres rinore para një rrjeti të madh ndërkombetar, *Gusht 2019.*



3.2 ROCK SOLID FOUNDATION-HOLAND-ESC.

Organizata partnere nga Holanda ka përzgjedhur një vullnetar nga Gjakova (Hasan Lala) për të punuar si vullnetar në periudhë 12 mujore. Qendra Rinore Ardhmëria është organizata derguese dhe projekti ka filluar në gusht 2019 dhe do të përfundoj në fund të Korrikut 2020. Projekti është financuar nga Erasmus+ me qëllim që të zhvillohen aftësitë rinore dhe për të shkëmbyer kultura të ndryshme.

Gusht 2019-Korrik 2020

3.3 TRAJNIM EVROPIAN

"TC ESCalator-neë levels of international volunteering" është zhvilluar në Republikën Qeke (qytetin Velké Pavlovice, Ekocentre Trkmanka), trajnimi është zhvilluar prej 10 -16 Shtator 2019 dhe ka pasur për qëllim që të krijohen partnershipe dhe projekte të përbashketa ndërmjet shteteve të Ballkanit përendimor dhe shteteve Evropiane. Në këtë trajnim ka marrur pjesë Menaxherja organizates (Vitore Zefi).

10 -16 Shtator 2019

3.4 DEMOCRACY PLUS



Trajnim për rëndësinë dhe metodat e shoqërimit të organizatave të shoqërisë civile nga bashkësi të ndryshme, në këtë trajnim kemi pasur dy përfaqësues nga Qendra Rinore në Qendren e Energjisë Civile në Graçanicë.

21 Dhjetor 2019.

3.5 UNDP/KOSOVË E SHËNDETSHME

- Trajnim për Menaxhimin e rrjeteve sociale dhe promovimin e organizates, trajnim 1 ditor është zhvilluar në hotelin Sirius në Prishtinë, Nëntor 2019-pjesëmarrës në këtë trajnim Dafinë Millaku.

-Trajnim i organizatave mjedisore për organizimin e kampanjave vetdijësuese, mobilizimin e komunitetit dhe pjesëmarrjen publike rreth qështjeve mjedisore, trajnim 3 ditor i zhvilluar në Gjakovë prej. Pjesëmarrës në këtë trajnim Dafinë Millaku & Heloina Elezaj.

13-15 hjetor 2019

4. PROJEKTET

- 1 Projekti “**Edukim Mjedisor**”, është financuar nga Balkan Green Foundation-Implementuar prej 1 Shtatori 2018-1 Prill 2019.
- 2 Projekti “ **Take care of the Enviroment if you want to live Healthier**” project I financuar nga UNDP. Implementuar nga Gusht 2019- Shkurt 2020.
- 3 Projekti ”**Zhvillimi i Rinisë**” , Subvencion nga Kuvendi Komunal i Klinës, Implementuar prej muajit Prill-Tetor 2019.

5. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

TABELA 1: Përfituesit e Qendres Rinore në bazë të Etnicitetit					
Perioda	Shqiptar	Serb	RAE	Tjera	Total
Janar-Dhjetor 2019	425	0	1	1	427
%	99.53	0.00	0.23	0.23	100.00




TABELA 2: Përfituesit e Qendres Rinore në bazë të Origjines			
Perioda	Rural	Urban	Total
Janar-Dhjetor 2019	134	293	427
%	31.38	68.62	100.00





TABLE 3: PË						Total
Perioda						
Janar-Dhjetor 2019	265	135	7	5	15	427
%	62.06	31.62	1.64	1.17	3.51	100.00



Periudha	Kurs gj.Angleze	Kurs gj.Italiane	Kurs gj.Gjermane	Gj.Frengje	Workshop edukativ	Iniciativa Rinore	Sport	Trajnime	Trajnim jashtë KS	Konferenca	Ngjarje Edukative	Ngjarje Kultureore
Janar-Dhjetor 2019	28	0	12	0	43	95	0	105	1	0	135	8
%	7	0	3	0	10	22	0	25	0	0	32	0

